

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË



**Përcaktimi i vlerës kultivuese dhe përdoruese (VKP) në disa gjenotipe të Elbit
(*Hordeum vulgare* L.) të hulumtuara në kushtet agroekologjike të Kosovës**

(Punim i Masterit)

MENTORI:

Prof. Ass. Dr. Dukagjin Zeka

KANDIDATJA:

BSc. Albulena Nikçi

Prishtinë, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë



Përcaktimi i vlerës kultivuese dhe përdoruese (VKP) në disa gjenotipe të Elbit (*Hordeum vulgare* L.) të hulumtuara në kushtet agroekologjike të Kosovës

Determination the value for cultivation or use (CVU) in some genotypes of Barley (*Hordeum vulgare* L.) researched in agro-ecological conditions of Kosovo

MENTORI:
Prof. Ass. Dr. Dukagjin Zeka

KANDIDATJA:
BSc. Albulena Nikçi

Prishtinë, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë



KOMISIONI:

- 1.
- 2.
- 3.

Prishtinë, 2021

PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	5
I. HYRJE.....	7
II. VËSHTRIM I LITERATURËS.....	10
III. QËLLIMET E TESTIMIT.....	11
IV. MATERIALI DHE METODA E PUNËS.....	12
PARAMETRAT E HULUMTUAR.....	14
4.1. Parametrat fushor.....	14
4.2. Parametrat laboratorik.....	14
MASAT AGROTEKNIKE TË APLIKUARA.....	16
4.3. Lokaliteti i Pejës.....	16
4.4. Lokaliteti i Lipjanit.....	16
V. REZULTATET E HULUMTIMIT ME DISKUTIM.....	18
5.1. Hulumtimet fushore.....	18
5.1.1. Matjet biometrike dhe periudhat e kallisjes.....	18
5.2. Hulumtimet laboratorike.....	25
5.2.1. Rezultatet e analizave fizike.....	25
5.2.2. Rezultatet e analizave kimike.....	34
VI. PËRFUNDIMET.....	49
VII. LITERATURA.....	53

Falënderim

*E ndjej për detyrim moral, njerëzor dhe intelektual, t’i shpreh falënderim të sinqertë **Prof. Ass. Dr.Dukagjin Zeka**, mentor i punimit të Masterit, i cili me përkushtim të thellë e të plotë, më ofroi ndihmën e gjithanshme profesionale e shkencore në përmbylljen e suksesshme të hulumtimeve dhe të punimit të Masterit.*

Profesor Zeka, më orientoi dhe kontriboi në thellimin e njohurive, nga lëma e shkencave bujqësore, përkatësisht të eksperimentimit fushor e laboratorik e deri te hartimi i dorëshkrimit i punimit kaq i thellë dhe voluminoz.

*Po ashtu, e falënderoj z. **Arton Bekolli**, nga Instituti Bujqësor i Kosovës, i cili më ka ndihmuar për ta realizuar dhe udhëhequr eksperimentin fushorë, dhe gjatë gjithë kohës përmes këshillave, metodave hulumtuese shkencore, nga fillimi e deri në përfundim të hulumtimeve, në gjitha fazat e punës deri në arritjen rezultateve finale, më ofroi jo vetëm ndihmën e duhur profesionale, por më ofroi edhe respektin e tij maksimal.*

Falënderoj, gjithë stafin akademik të fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, për qasjen dhe ofrimin e informacionit profesional e shkencor, gjatë gjithë kohës së studimeve të nivelit Master.

Falënderoj familjen për ndihmën, kontributin, për kujdesin dhe durimin e treguar, për t’ju qasur dhe përfunduar studimeve të nivelit Master, në shkencat bujqësore në Universitetin e Prishtinës-Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Përmbledhje

Kultivimi i elbi (*Hordeum Vulgare L.*) për ekonominë e Kosovës ka një rëndësi të veçantë, sepse jo vetëm që gjen kushte të mira ekologjike për kultivim, por është bazë për industrinë e birrës, ndërsa fermerët e përdorin në fermat e tyre, si ushqim për kafshë mjaftë të rëndësishëm. Për kultivim të suksesshëm dhe arritje të rendimentit sa më të lartë dhe cilësor, duhet kushtuar rëndësi të veçantë përcaktimit të kultivarit, i cili duhet të jetë i përshtatshëm për kushtet agro klimatike, si dhe të jetë rezistent ndaj sëmundjeve. Prandaj, për të maksimizuar fitimin e tyre, kompanitë e prodhimit të elbit për birrë dhe fermerët duan njohuri për kultivarë më të përshtatshëm, që plotëson kërkesat në rritje për fermat e tyre. Qëllimi i hulumtimeve ishte përcaktimi i faktorëve që ndikojnë në arritjen e prodhimit dhe cilësisë tek elbi, duke u bazuar në parametra të ndryshëm (fizik dhe kimik). Në këtë rast, u ngritën fushat eksperimentale në dy regjione të ndryshme agro klimatike të Republikës së Kosovës, në Rrafshin e Dukagjinit në Vitomericë – Pejë, dhe në Rrafshin e Kosovës në Lipjan, me qëllim për të marrë shumë informata lidhur me reaksionin e faktorëve të ndryshëm, si në vijim:

1. Kultivarët e elbit: “E-1”, “E-2”, dhe “Grand” i cili ishte kultivar standard apo krahasues;
2. Efektet e faktorit ekologjik, lokalitetet: (Pejë dhe Lipjan);
3. Afate mbjellëse: Pejë = 21.10.2019 dhe Lipjan = 23.10.2019;
4. Dendësia mbjellëse e farave : 550 fara / m².

Dizajni eksperimental ishte plani i plotë i rastit në bllok (PPRB) me tri përsëritje për secilin kultivar dhe lokalitet. Matjet biometrike, janë realizuar gjatë vegetacionit, që janë: periudha e kallisjes (data e kallisjes), lartësia e kërcellit (cm) dhe numri i bimëve/m² që është nxjerrë pas korrjes. Po ashtu, janë analizuar edhe parametrat tjerë në kushte laboratorike, që janë: rendimenti (kg/ha), pesha hektolitare (kg/hl), pesha absolute (g), proteinat (%), gluteni (%), sedimenti (%), amidoni (%) dhe lagështia në kokërr (%).

Për gjithë këta faktorë kompleks, rezultatet mesatare të parametrave hulumtues, ishin:

- Numri i bimëve / m² = Pejë (657 bimë/m²) dhe Lipjan (639.5 bimë/m²);
- Lartësia mesatare e kërcellit = Pejë (99.81 cm) dhe Lipjan (99.33 cm);
- Rendimenti mesatar = Pejë (7.48 t/ha) dhe Lipjan (6.79 t/ha);
- Pesha hektolitare mesatare = Pejë (69.27 kg/hl) dhe Lipjan (67.17 kg/hl);
- Pesha mesatare e 1000 farave = Pejë (45.57 g) dhe Lipjan (43.07 g);
- Proteinat mesatare = Pejë (14.70 %) dhe Lipjan (15.10 %);
- Gluteni mesatar = Pejë (29.80 %) dhe Lipjan (31.10 %);

- Sedimenti mesatar = Pejë (43.43 %) dhe Lipjan (45.77 %);
- Amidoni mesatar = Pejë (57.53 %) dhe Lipjan (57.30 %), dhe
- Lagështia mesatare në momentin e korrjes = Pejë (10.67 %) dhe Lipjan (11.93 %)

Kompanitë prodhuese apo fermerët që kultivojnë elbin, duhet të zgjedhin faktorin dhe kultivarin më të përshtatshëm për të realizuar prodhim sa më të lartë dhe cilësor, pa rritur koston e prodhimit.

Sipas rezultateve të arritura faktori gjenetikë për kultivarët e elbit, ishte me kapacitete prodhues të ndryshme për akumulim të rendimentit dhe parametrave tjerë hulumtues, andaj zgjedhja e kultivarit me potencial të lartë gjenetikë dhe i përshtatshëm për lokalitet të caktuar, është zgjidhja më e favorshme e fermerëve në përgjithësi që kultivojnë elb.

Rezultatet e fituara, ishin subjekt i (ANOVA) përkatësisht modelit të përgjithshëm linear (MPL), me programin MINITAB 18.

I. HYRJE

Elbi është një kulturë njëvjeçare dhe varësisht nga kultivari, mund të mbillet në vjeshtë apo edhe në pranverë. Të gjithë kultivarët e elbit bëjnë pjesë në specien *Hordeum Vulgare*, me numër diploid të kromozomeve $2n = 14$. Në sistemin e gamisë elbi është bimë plotësisht autogame, ndërsa pllenimi ndodhë në çdo lule ku i ka të zhvilluar të dy gjinitë. Fara e elbit në të shumtën e rasteve është kokërr e veshur, por mund të jetë edhe farë e zhveshur, varësisht nga kultivari. Po ashtu, parametrat e kallirit, numri i rreshtave dhe forma e kokrrës janë karakteristika të kultivarit. Në format shumëëndëshe mbizotëron forma rrombrike me ngjyrë të kuqërremtë. Në kultivarët e elbit distik (elbi i birrës) mbizotëron forma e eliptike e farës me ngjyrë të zverdhur në të bardhë. Produkti kryesor që fitohet nga elbi distik (elbi i birrës) është “Malti”. Me fjalën maltim nënkuptojmë mbirjen e drithërave nën kushtet e krijuara në mënyrë artificiale, respektivisht adaptimin e kushteve të ambientit për mbirjen e kokrrës së drithërave në formë artificiale. Prodhimi që përfitohet nga drithërat në këto kushte quhet Maltë i gjelbër, me tharjen e maltit të gjelbër, përfitohet malti i tharë. Në kohën antike në Greqi, elbi kishte qenë bazë themelore në përgatitjen e bukës, po ashtu e kanë konsideruar si ushqim shumë të rëndësishëm në burimin e fuqisë tek sportistët. Elbi ka qenë i çmuar edhe në kohën Kinës së lashtë, ndërsa e kanë konsideruar edhe si simbol i pjekurisë mashkullore. Mesatarja e përmbajtjes kimike e elbit është e përafërt me drithëra të tjera. Elbi është i pasur me minerale: kalium, fosfor, magnez, hekur, mangan, zing, selen etj. Sikurse edhe shumica e drithërave, përmban sasia të mëdha të vitaminës B komplekse dhe sasira të vogla të vitaminave të tjera (vitamina A, E dhe K). Elbi më se shumti shfrytëzohet si lëndë e parë për përfitimin e birrës, viskit, si dhe për ushqimin blegtoral. Maltimi i drithërave ka për qëllim përfitimin e enzimave si përbërës më rëndësi në industrinë e birrës. Mbirja artificiale që ka për qëllim përfitimin e prodhimit me sasi sa më të mëdha të enzimave, ndryshimi i strukturës së kokrrës dhe reaksioni kimik – biologjik që kryhen gjatë këtij procesi e që janë më rëndësi sekondare. Vartësisht nga kushtet klimatike dhe ato tokësore, elbi kultivohet (mbillet) në dy sezona, në vjeshtë dhe pranverë, megjithatë kjo varet nga kultivari. Periudha më e përshtatshme për mbjelljen e elbit vjeshtor në Kosovë, fillon pas javës së parë dhe zgjatë deri në fund muajit Tetor, ndërsa mbjellja e elbit pranverorë fillon nga mesi deri në fund të muajit Mars. Mbjellja e hershme në pranverë, ka për qëllim të krijoj një periudhë sa më të gjatë vegjetative. Sasia mesatare e farës sillet rreth 180 - 200 kg/ha, kjo sasi i përgjigjet përafërsisht 330 kokrra për m^2 dhe që siguron përafërsisht nga 500 deri 700 kërcej apo kallinjë për m^2 . Distanca në mes të rendave duhet të jenë 13 maksimal 20 cm (mesatarja

15-18 cm). Thellësia e mbjelljes arrinë 2 -3 cm. Elbi fillon të mbijë në temperaturë prej 5–6⁰C, pas 3-4 ditë në kokrrën e mbjellur paraqitën rrënjëzat e para, pas 6-8 ditë gjethi embrional fillon të depërtoj mbi sipërfaqe të tokës, njëkohësisht fillon të formohet nyja e vëllazërimit nga i cili fillojnë të dalin 2-4 kërcej sekondar pranë kërcellit kryesor. Kokërrat e elbit janë kryesisht me hjedhza, pjesët kryesore të kokrrës janë: Embrioni, pjesa miellore (endosperma) dhe mbështjellësit: (hjedhza, cipa e embrionit dhe cipa e farës). Përbërjen kimike kokrra e elbit e ka: 12-20% ujë dhe 80-88% materie të thatë. Ndërsa, enzimet e elbit të birrës dhe të maltit janë paraqitur, si në vijim: oksidoreduktazat, tansferazat, hidrolizat, liazat, izomerazat dhe ligazet. Elbi i deponuar në kushte normale, duhet të përmbajë 12 % lagështinë kokërr. Shkalla e lagështisë së elbit gjatë ruajtjes duhet të jetë e ulët, në mënyrë që të luftohen të gjitha aktivitetet jetësore në kokërr, të cilat mundësojnë krijimin e humbjeve të vlerës përdoruese të sajë. Aktivitetet jetësore në kokërr në mënyrë të dukshme rriten kur shkalla e lagështisë në kokërr arrinë rreth 30 %, atëhere kokrra e elbit fillon procesin e mbishmërisë në mënyrë uniforme. Procesi i mbishmërisë karakterizohet me disa faktor të rëndësishëm, si pranimi i lagështisë, fillimi i zhvillimit të embrionit, dhe transformimi i materieve rezervë që gjenden në endospermën e kokrrës. Ndryshimet e para morfologjike që mund të vërehen gjatë rritjes së embrionit janë në rrënjë e më vonë edhe në gjethë. Procesi i këtyre ndryshimeve fiziologjike mund të vërehet pas 12 orëve kur kokrra e elbit ka qendruar në ndikimin e lagështisë fillon t'i shfaqë shenjat e para të jetës së vet. Për tu paraqitur maja e parë e rrënjëzës kryesore në sipërfaqen e kokrrës, në mburojën e saj formohet depoja e substancave rezerve ushqyese, që zërthejnë për ushqimin e bimës së re. Sasia e tyre rritet me grumbullimin e mjaftuar të sasirave të ligninës, atëherë fillon edhe zbërthimi e shtresës së qelizave zgjatuese. Qelizat e epitelit thithës zgjatën për tri here më shumë për 72 orë. Në këtë rast, detyra e Fabrikës së maltit është ku për shkak të ndryshimeve komplekse që zhvillohen në kokrrën e elbit gjatë mbirjes, të bëhet udhëheqja në atë mënyrë që më anë të shkëmbimit të materies të arrihen sasira sa më të mëdha të produkteve zbërthuese. Gjatë kësaj duhet pasë kujdes edhe në dallime që ekzistojnë te kokrra e elbit, për nga varieteti, viti i prodhimit, kushtet natyrore gjatë zhvillimit, kushtet e korrijës dhe kushtet tjera që janë specifike për këtë lami. Temperatura mbirëse ashtu siç është thënë në pjesën teorike luan rol më rëndësi në rritjen e elbit, në sintetizim ashtu edhe në veprimin enzimatik. Gjatë udhëheqjes së mbirjes me anë të temperaturave të ulta në intervale prej 12 deri 16⁰C, mbirja është më e suksesëshme atëhere kur temperatura është më e lartë. Për shkak të përmbajtjes së lartë të lagështisë malti i gjelbërt shumë lehtë prishet, atëhere duhet tharë deri në atë masë që mund të ruhet sa më mirë. Përveç kësaj, duhet pasur kujdes të posaçëm që

të bëhet transformimi i plotë i kokrrës sa i përket natyrës kimiko-biologjike, që ka filluar gjatë mbirjes, në kahjen e disa grupeve përbërse që duhet fiksuar. Detyra e tharjes ka për qëllim, largimin e mëtutejm të aromes si dhe shijën e maltit të gjelbërt, që në një mënyrë janë të përvetësuara nga drithërat, vartësisht nga tipi i maltit përfitohet aromë karakteristike e kokrrës dhe ngjyra e caktuar. Në këtë rast, i domosdoshëm është largimi i rrënjëzave, pasi që ato janë higroskopike dhe përsëri thithin lagështinë nga ambienti duke shkaktuar lagështi edhe për maltin e gjelbërt që është i padëshiruar pas tharjes. Qëllimet e përmendura arrihen vetëm nëpërmjet tharjes. Gjatë tharjes në maltin e gjelbërt vjen deri të ndryshimi i thellë fizik dhe kimik. Lagështia e kokrrës së maltit të gjelbërt, në përfundim të mbirjes gjatë metodës konvencionale të maltimit është 41 – 43 %, ndërsa me metodat bashkëkohore intensive arrihet deri në 45 – 50 %, gjatë kohës së tharjes zvogëlohet në 3,5 – 4 %, ndërsa te malti i shëndritshëm dhe ai i murrëm 1,5 – 2%. Për tharjen dhe tharjen plotësuese të maltit përdoren tharset për malt, në të cilat tharja bëhet duke e përshkuar rrymën e ajrit për tharje. Në këtë rast, ja vlenë të theksohet se elbi për ekonominë e Kosovës ka një rëndësi të veçantë, sepse jo vetëm që gjen kushte të mira ekologjike për kultivim, por është bazë për industrinë e birrës dhe ushqimin e kafshëve.

II. VËSHTRIM I LITERATURËS

Elbi (*Hordeum Vulgare L.*) në disa zona ka traditë të gjatë të kultivimit, me qëllim të përdorimit në ekonomitë bujqësore, por historiku i kultivimit të elbit në Kosovë është ngushtë i lidhur me birrarinë e Pejës, pasi që kultivimi i kësaj kulture është i lidhur ngushtë me nevojat e saj. Zakonisht, vendet e njohura për prodhimin e birrës kanë edhe sipërfaqe të konsiderueshme të kultivuar me elb. Në vendet e BE-së, prodhuesit më të dalluar janë: Gjermania mbi 10.3 milionë/t, Franca 10.3 milionë/t, Spanja 10 milionë/t, Mbretëria e Bashkuar mbi 7 milionë/t (EUROSTAT, 2013). Elbi për ekonominë e Kosovës ka një rëndësi të veçantë, sepse jo vetëm që gjen kushte të mira ekologjike për kultivim, por është bazë për industrinë e birrës dhe ushqimin e kafshëve. Sikurse edhe të drithërat e tjerë, edhe në këtë rast, rajoni i Prishtinës ka numrin më të madh të Ekonomive Bujqësore dhe sipërfaqen më të madhe, me pjesëmarrje 46% dhe 52%, kurse rajonet e Gjakovës dhe Ferizajt kanë pjesëmarrje me nga 2%, si për nga numri i EB-ve, ashtu edhe nga sipërfaqja në nivel vendi (ASK, Kulturat e Arave në Republikën e Kosovës, 2014;)

Sa i përket komunave, komuna e Graçanicës ka numrin më të madh të Ekonomive Bujqësore (393) dhe sipërfaqen më të madhe të kultivuar me elb, 267.28 ha, ndërsa një mori komunash kanë më pak se 100 ha të kultivuar me elb (ASK, Kulturat e Arave në Republikën e Kosovës, 2014;). Tek kjo kulturë, 53% e sipërfaqes së kultivuar i përket madhësisë së klasës mbi 1 deri 2 ha, 2 deri 5 ha dhe mbi 5 ha.

III. QËLLIMET E TESTIMIT

Objekti dhe qëllimi i testimit ishte, hulumtimi i disa kultivarëve të elbit për përshtatshmërinë e tyre në kushte të ndryshme agro klimatike të Republikës së Kosovës. Kultivarët e testuar ishin me origjinë nga vende të ndryshme të regjionit dhe më gjerë, ndërsa ata janë hulumtuar gjatë vegetacionit të vitit 2019 / 2020. Në hulumtim janë përfshirë tre (3) kultivarë të elbit, dy prej tyre (E1 dhe E2), ishin kultivarë që janë testuar për herë të parë në Kosovë, ndërsa rezultatet e tyre janë krahasuar me ato të kultivarit standard apo krahasues “Grand”. Parametrat e hulumtuar ishin: karakteristika morfologjike, matje biometrike dhe analiza të ndryshme fizike dhe kimike. Nga të gjithë parametrat e lartcekur janë arritur rezultatet që e përcaktojnë Vlerën Kultivuese dhe Përdoruese (VKP) në kulturën e elbit. Të njëjzat rezultate të hulumtimeve janë vlerësuar nga Komisioni për Listën e Farërave në Kosovë, me qëllim regjistrimin e këtyre dy kultivarëve testues në ***“Listën e Lejuar të Farërave në Republikën e Kosovës”***.

IV. MATERIALI DHE METODA E PUNËS

Hulumtimet janë realizuar në dy regjione të ndryshme agro klimatike dhe tokësore të Republikës së Kosovës (në Rrafshin e Dukagjinit dhe Rrafshin e Kosovës). Në rrafshin e Dukagjinit, fushat testuese janë mbjellur në fermën eksperimentale të Institutit Bujqësor të Kosovës, në Vitomicë / Pejë, ndërsa në rrafshin e Kosovës, fushat testuese janë mbjellur në pronën e Shkollës së Mesme Profesionale (SH.M.P) “Adem Gllavica” në Lipjan. Eksperimentet ishin vendosur sipas metodës së blloqeve të randomizuar, ndërsa sipërfaqja e çdo ngastre eksperimentale ishte se $10\text{ m}^2 \times 3$ përsëritje për secilin kultivarë dhe lokalitet testues. Mbjellja e ngastrave eksperimentale është bërë me makinë speciale, tipi i makinës Hege 80, me 6 rende mbjellëse. Norma e farës ishte 550 fara / m^2 , për secilin kultivar dhe lokalitet testues. Kultivarët kishin karakteristika të ndryshme morfologjike, në këtë rast, njëri kultivar (E-2) kallirin e kishte 2 rendësh, ndërsa kultivarët E-1 dhe Grand, kallirin e kishin 6 rendësh. Parametrat e hulumtuar ishin, fushor dhe laboratorik. Parametrat fushor janë vlerësuar në fenofaza të ndryshme gjatë vegjetacionit në dy regjionet agro klimatike. Ndërsa, analizat e ndryshme laboratorike të farërave (fizike dhe kimike), janë realizuar në Laboratorin Nacional Referent për Cilësi dhe Çertifim të Farërave, i cili funksionon në kuadër të Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK) në Pejë.



Fotografia 1. Përgatitja e parcelave ku janë realizuar mbjelljet e fushave eksperimentale të elbit në Vitomericë / Pejë, Tetor 2019.



Fotografia 2. Mbjellja e fushave eksperimentale të elbit me makinë speciale, tipi Hege 80, Vitomericë /Pejë, Tetor 2019

PARAMETRAT E HULUMTUAR

Parametrat hulumtues ishin të ndryshëm (fushor dhe laboratorik), disa prej tyre janë hulumtuar në fenofaza të ndryshme gjatë vegetacionit, dhe disa të tjerë pas korrjes së fushave eksperimentale, janë analizuar në kushte laboratorike. Parametrat hulumtues dhe analizat e ndryshme janë paraqitur, si në vijim:

4.1. Parametrat fushor

- ✓ Numri i bimëve (m²),
- ✓ Gjatësia e kërcellit (cm),
- ✓ Periudhat e kallisjes – datat.

4.2. Parametrat laboratorik

- ✓ Rendimenti – t/ha
- ✓ Masa hektolitare – kg/hl,
- ✓ Masa absolute – g,
- ✓ Proteinat %,
- ✓ Gluteni %,
- ✓ Sedimenti %,
- ✓ Amidoni %,
- ✓ Lagështia %.



Fotografia 3. Aparaturë për kryerjen e analizave kimike në kokërr të drithërave
(FOSS, Infratec™ 1241 Grain Analyzer)



Fotografia 4. Aparaturë e peshës hektolitare (kg/hl), së bashku me peshoren e saj të përshtatshme për matje



Fotografia 5. Numërues i farërave të ndryshme

MASAT AGROTEKNIKE TË APLIKUARA

Në këtë rast, aplikimi i masave agroteknike në të gjitha fushat eksperimentale ishte i njëjtë për secilin kultivarë dhe lokalitetet. Të gjitha masat agroteknike të aplikuar janë paraqitur, si në vijim:

4.3. Lokaliteti i Pejës

- ✓ Parakultura: Patate dhe Misër
- ✓ Punimi themelor, data: 14 - 15.10.2019,
- ✓ Plehërimi bazë, NPK-16:16:16, sasia 400 kg / ha, data: 17.10.2019,
- ✓ Punimet plotësuese, pijatimi, frezimi, matja dhe ndarja e fushave, data: 17.10.2019,
- ✓ Mbjellja, data: 21.10.2019,
- ✓ Riplehërimi i parë është bërë me Urea 46% N, sasia 200 kg / ha, data: 18.02.2020,
- ✓ Trajtimi i parë me insekticid Lamdex^R 50 SC, sasia 200 ml/ha, dhe fungicid Falcon EC 460, sasia 500 ml / ha, data: 08.04.2020,
- ✓ Trajtimi i dytë me herbicide: Secator OD, sasia 150 ml / ha, dhe Furore Super, sasia 800 ml / ha, data: 12.04.2020,
- ✓ Ri plehërimi i dytë me NAG 27 %, sasia 200 kg / ha, data: 19.04.2020,
- ✓ Korrja e fushave eksperimentale të elbit , data:10.07.2020.

4.4. Lokaliteti i Lipjanit

- ✓ Parakultura: Misër
- ✓ Punimi themelorë, data: 16.10.2019,
- ✓ Plehërimi bazë, NPK-16:16:16, sasia 400 kg / ha, data: 22.10.2019,
- ✓ Punimet plotësuese, pijatimi, frezimi, matja dhe ndarja e fushave, data: 22.10.2019,
- ✓ Mbjellja, data: 23.10.2019,
- ✓ Riplehërimi i parë është bërë me Urea 46 % N, sasia 200 kg / ha, data: 19.02.2020,
- ✓ Trajtimi i parë me herbicide: Secator OD, sasia 150 ml / ha, dhe Furore Super, sasia 800 ml / ha, data: 15.04.2020,
- ✓ Trajtimi i dytë me fungicid Falcon, sasia 500 ml / ha, data: 19.04.2020,
- ✓ Ri plehërimi i dytë me NAG 27 %, sasia 200 kg / ha, data: 24.04.2020 ,
- ✓ Korrja e fushave eksperimentale të elbit, data: 15.07.2020 .



Fotografia 6. *Pamje e fushave të elbit, grurit dhe tritikaleve pas ndarjes dhe përkufizimit të tyre, në Vitomericë / Pejë 2020*



Fotografia 7. *Trajtimi i fushave të elbit, grurit dhe tritikaleve me preparate mbrojtëse, Lipjan 2020*

V. REZULTATET E HULUMTIMIT ME DISKUTIM

5.1. Hulumtimet fushore

Pas procesit të mbjelljes dhe pas mbishmërisë, në fushat eksperimentale të elbit të cilat ishin vendosur në dy regjionet e ndryshme agroklimatike të Kosovës, është bërë hulumtimi i disa parametrave fushor, që ishin: numri i bimëve për m², lartësia e kërcellit (cm), dhe periudhat e kallisjes (datat). Rezultatet e këtyre parametrave luajnë rol të rëndësishëm në përcaktimin e Vlerës Kultivuese dhe Përdoruese (VKP) të tyre, ndërsa ato janë paraqitur në tabelën 1.

5.1.1. Matjet biometrike dhe periudhat e kallisjes


Tabela 1. Parametrat biometrike dhe periudhat e kallisjes te elbi të testuara në dy lokalitete të ndryshme (Pejë dhe Lipjan)								
Kultivarët	Numri i bimëve për m ²			Lartësia e kërcellit (cm)			Periudhat e kallisjes	
	Pejë	Lipjan	X	Pejë	Lipjan	X	Pejë	Lipjan
E-1	628.50	685.50	657.00	97.11	99.33	98.22	29.04.2020	11.05.2020
E-2	784.50	655.50	720.00	98.22	100.00	99.11	27.04.2020	09.05.2020
St. Grand	558.00	577.50	567.75	104.11	98.67	101.39	08.05.2020	15.05.2020
Mesatarja	657.00	639.50	648.25	99.81	99.33	99.57	-	-
Maksimale	784.50	685.50	720.00	104.11	100.00	101.39	-	-
Minimale	558.00	577.50	567.75	97.11	98.67	98.22	-	-
Dallimi	226.50	108.00	152.25	7.00	1.33	3.17	-	-
%	28.87	15.75	21.15	6.72	1.33	3.13	-	-

Në tabelën e sipërme, janë paraqitur të dhënat numerike për disa parametra, që janë hulumtuar gjatë vegjetacionit në fusha testuese. Eksperimentet fushore të elbit ishin vendosur në dy regjionet agroklimatike të Republikës së Kosovës (në lokalitetet Pejë dhe Lipjan). Në rezultatet e arritura shihen kjo që ishin variabile, në raport me kultivarin standard apo krahasue Grand. Po ashtu, sa i përket periudhave të kallisjes, rezultatet treguan se kultivarët testues kishin periudha të ndryshme vegjetative, në raport me kultivarin standard apo krahasues. Kultivari që ka treguar periudhën më të hershme të kallisjes në lokalitetin e Pejës ishte, E-2 nga data: 27.04.2020, ndërsa periudhën më të vonë të kallisjes në këtë lokalitet e kishte kultivari standard apo krahasues Grand, nga data: 08.05.2020. Ndërsa, kultivari tjerë testues E-1, në lokalitetin e Pejës periudhën e kallisjes e kishte nga data: 29.04.2020. Periudhën më të hershme të kallisjes në lokalitetin e Lipjanit e kishte i njëjti kultivarë E-2, nga data: 09.05.2020, ndërsa në këtë lokalitet periudhën më të vonë të kallisjes e kishte po ashtu i njëjti kultivarë, që në këtë rast ishte ai standard apo krahasues Grand, nga data: 15.05.2020.


Kurse kultivari tjerë testues E-1 i përfshirë në hulumtim, periudhën e kallisjes e kishte nga data: 15.05.2020. Rezultatet e parametrave biometrike (*numri i bimëve për m² dhe lartësia e kërcellit*), që shihen në tabelën 1, janë paraqitur në grafikët nga 1 deri 4.



Fotografia 8. Matja e lartësisë së kërcellit në fushat testuese të elbit, grurit dhe tritikaleve në Vitomericë / Pejë, 2020



Fotografia 9. Gjatë realizimit të analizave laboratorike në Laboratorin Nacional Referent për Cilësi dhe Çertifikim të Farërave në IBK - Pejë




Grafiku 1. Numri i bimëve për m² te elbi i testuar dhe krahasuar në mes dy lokaliteteve testuese (Pejë dhe Lipjan)

Në grafikun e mësipërm, janë paraqitur rezultatet mesatare të fushave eksperimentale të elbit, ku është përcaktuar numri i bimëve për m² në lokalitetet Pejë dhe Lipjan. Numrimi i bimëve është bërë në secilen fushë testuese dhe secilin kultivarë. Ndërsa, rezultatet e dy kultivarëve testues, janë krahasuar me rezultatet e kultivarit standard apo krahasues “Grand”. Në këtë rast, dendësia më e madhe të bimëve për m² në lokalitetin e Pejës është vërejtur tek kultivari E-2 (784.5 bimë / m²), ndërsa dendësia më e ulët e ishte vërejtur tek kultivari standard Grand (558 bimë / m²). Dallimi në mes dendësisë maksimale dhe asajë minimale ishte 226.50 bimë për m², apo 28.87 % dendësi më të madhe kishte kultivari E-2, në raport me kultivarin standard Grand që në këtë rast e kishte dendësinë minimale. Ndërsa, kultivari tjetër testues E-1 kishte 628.5 bimë / m². Dendësia mesatare e bimëve / m², e të gjithë kultivarëve testues përfshirë edhe atë standard apo krahasues, në lokalitetin e Pejës, ishte 628.5 bimë / m². Në këtë rast, në lokalitetin e Lipjanit dendësia më e madhe të bimëve për m² është vërejtur tek kultivari E-1 (685.5 bimë / m²), ndërsa dendësia më e ulët e ishte vërejtur tek kultivari standard Grand (577.5 bimë / m²). Dallimi në mes dendësisë maksimale dhe asajë minimale ishte 108 bimë / m², apo 15.75 % dendësi më të madhe kishte kultivari E-1, në raport me kultivarin standard apo krahasues Grand, që e kishte dendësinë minimale. Ndërsa, kultivari tjetër testues E-2 kishte 655.5 bimë / m². Dendësia mesatare e bimëve për m², e të gjithë kultivarëve testues përfshirë edhe atë standard apo krahasues në lokalitetin e Lipjanit, ishte 639.5 bimë / m².

Sic shihet nga tabela 2 analiza e variancës ka gjetur dallime sinifikante mes gjenotipeve por jo edhe mes lokaliteteve.

Tabela 2. Analiza e variancës për bimë/m²


Burimi	ShL	Adj SS	Adj MS	F	P
Lokaliteti	1	1378	1378.1	0.66	0.429
Kultivari	2	70229	35114.6	16.93	0.000
Gabimi	14	29036	2074.0		
Lack-of-Fit	2	29027	14513.6	19013.48	0.000
Gabimi i pastër	12	9	0.8		
Totali	17	100644			



Grafiku 2. Mesatarja e përgjithshme e numrit të bimëve për m² te elbi, përfshirë dy lokalitetet testuese (Pejë dhe Lipjan)

Në grafikun e mësipërm, janë paraqitur rezultatet mesatare të numrit të bimëve / m² për të gjithë kultivarët e elbit që janë testuar në dy lokalitetet, Pejë dhe Lipjan. Në këtë rast, mesataren maksimale të numrit të bimëve për m² në dy lokalitetet, kishte treguar kultivari E-2 (720 bimë / m²), ndërsa numrin më të ulët të bimëve për m² në dy lokalitetet e kishte kultivari standard apo krahasues Grand (567.75 bimë / m²). Dallimi në mes mesatares maksimale dhe asaj minimale, ishte 152.25 bimë / m², apo 21.15 % dendësi më të madhe kishte kultivari E-2, në raport me kultivarin standard Grand që në këtë rast e kishte numrin minimal të bimëve për m² në dy lokalitetet. Ndërsa, kultivari tjetër testues


E-1 kishte 657 bimë / m². Mesatarja e përgjithshme e dendësisë së bimëve / m², për të gjithë kultivarët testues përfshirë atë standard apo krahasues (Grand) në dy lokalitetet (Pejë dhe Lipjan), ishte 648.25 bimë / m².



Grafiku 3. Lartësia e kërcellit (cm) te elbi i testuar dhe krahasuar në mes dy lokaliteteve (Pejë dhe Lipjan)

Në grafikun e mësipërm, janë paraqitur rezultatet mesatare të fushave eksperimentale të elbit, ku është matur lartësia e kërcellit (cm) në lokalitetet Pejë dhe Lipjan. Lartësia e kërcellit është matur në secilin secilin kultivarë dhe fushë testuese, ndërsa rezultatet e dy kultivarëve testues janë krahasuar me rezultatet e kultivarit standard apo krahasues Grand. Në këtë rast, lartësia më e madhe e kërcellit në lokalitetin e Pejës është vërejtur tek kultivari standard Grand (104 cm), ndërsa lartësia më e ulët e ishte vërejtur tek kultivari E-1 (97.11 cm). Dallimi në mes dendësisë maksimale dhe asajë minimale ishte 7 cm, apo 6.72 % lartësi më të madhe kishte kultivari standard Grand, në raport me kultivarin E-1, që në këtë rast e kishte lartësinë minimale. Ndërsa, kultivari tjetër testues E-2 parametrin e lartësisë e kishte 98.22 cm. Lartësia mesatare e kërcellit (cm), e të gjithë kultivarëve testues përfshirë edhe atë standard apo krahasues në lokalitetin e Pejës, ishte 99.81 cm. Në këtë rast, në lokalitetin e Lipjanit lartësia më e madhe e kërcellit është vërejtur tek kultivari E-2 (100 cm), ndërsa lartësia më e ulët e ishte vërejtur tek kultivari standard Grand (98.67 cm). Dallimi në mes lartësisë maksimale dhe asajë minimale ishte 1.33 cm, apo 1.33 % lartësi më të madhe të kërcellit kishte kultivari E-2, në raport me kultivarin standard apo krahasues Grand, që e kishte lartësinë minimale. Ndërsa, kultivari tjetër testues E-1 lartësinë e kërcellit e kishte 99.33 cm. Lartësia

mesatare e kërcellit e të gjithë kultivarëve testues përfshirë edhe atë standard apo krahasues në lokalitetin e Lipjanit, ishte 99.33 cm.



Grafiku 4. Mesatarja e përgjithshme e lartësisë së kërcellit (cm) te elbi, përfshirë dy lokalitetet testuese (Pejë dhe Lipjan)

Në mënyrë grafike (grafiku 4.), janë paraqitur rezultatet mesatare të lartësisë së kërcellit (cm), për të gjithë kultivarët e elbit që janë testuar në dy regjionet agro klimatike të Republikës së Kosovës, në lokalitetet (Pejë dhe Lipjan). Në këtë rast, mesataren maksimale të lartësisë së kërcellit në dy lokalitetet kishte treguar kultivari standard Grand (101.39 cm), ndërsa lartësi më të ulët të bimëve për dy lokalitetet e kishte treguar kultivari E-1 (98.22 cm). Dallimi në mes lartësisë mesatare maksimale dhe asajë minimale ishte 3.17 cm, apo 3.13 % lartësi më të madhe të kërcellit kishte kultivari standard Grand, në raport me kultivarin E-1, që në këtë rast e kishte gjatësinë minimale të kërcellit në dy lokalitetet. Kultivari tjetër testues E-2, lartësinë mesatare të kërcellit në dy lokalitet e kishte 98.44 cm. Mesatarja e përgjithshme e lartësisë së kërcellit në dy lokalitetet (Pejë dhe Lipjan), duke e përfshirë edhe kultivarin standard krahasues, ishte 99.57 cm.

ANOVA për lartësi të kërcellit nuk ka gjetur sinifikance në asnjërin nivel të rëndësisë për lokalitetin apo gjenotipin (tabela 3).

Tabela 3. Analiza e variancës për lartësi të kërcellit cm

Burimi	ShL	Adj SS	Adj MS	F	P
Lokaliteti	1	1.027	1.0272	0.23	0.636
Kultivari	2	32.061	16.0305	3.66	0.053
Gabimi	14	61.284	4.3774		
Lack-of-Fit	2	55.548	27.7742	58.11	0.000
Gabimi i pastër	12	5.736	0.4780		
Totali	17	94.372			

5.2. Hulumtimet laboratorike

Pas korrjes së fushave eksperimentale të elbit, të gjithë kultivarët e hulumtuar janë analizuar në kushte laboratorike për parametrat e tyre fizik dhe kimik. Parametrat e hulumtuar ishin: rendimenti (t / ha), pesha hektolitare (kg / hl), pesha e 1000 farave (g), proteinat (%), gluteni (%), sedimenti (%), amidoni (%) dhe lagështia në momentin e korrjes (%). Në tabelën 4, janë paraqitur rezultatet e analizave fizike, ndërsa rezultatet e analizave kimike janë paraqitë në tabelat 3 dhe 4.

5.2.1. Rezultatet e analizave fizike

Tabela 4. Rezultatet e analizave fizike të elbit i testuar për VKP-në e tyre

Kultivarët	Rendimenti (t/ha)			Masa hektolitare (kg/hl)			Masa e 1000 farave		
	Pejë	Lipjan	X	Pejë	Lipjan	X	Pejë	Lipjan	X
E-1	7.90	7.20	7.55	67.80	67.70	67.75	42.42	40.28	41.35
E-2	7.17	5.97	6.57	69.00	67.90	68.45	48.70	45.10	46.90
Grand	7.38	7.20	7.29	71.00	65.90	68.45	45.60	43.82	44.71
Mesatarja	7.48	6.79	7.14	69.27	67.17	67.75	45.57	43.07	44.32
Maksimale	7.90	7.20	7.55	71.00	67.90	68.45	48.70	45.10	46.90
Minimale	7.17	5.97	6.57	67.80	65.90	67.75	42.42	40.28	41.35
Dallimi	0.73	1.23	0.98	3.20	2.00	0.70	6.28	4.82	5.55
%	9.24	17.08	12.98	4.51	2.95	1.02	12.90	10.69	11.83


Në tabelën e sipërme (tab.4.), janë paraqitur rezultatet e parametrave fizik, që janë analizuar pas korrjes së fushave eksperimentale të elbit. Eksperimentet fushore të elbit ishin vendosur në dy regjionet agro klimatike të Republikës së Kosovës (në lokalitetet Pejë dhe Lipjan). Korrja e fushave eksperimentale të elbi është bërë me makinë speciale, tipi i makinës *WINTERSTAIGER*, me gjerësi të Hederit 1 metër. Ndërsa, parametrat e hulumtuar ishin: rendimenti, pesha hektolitare dhe pesha e 1000 farave (*pesha absolute*). Nga rezultatet e paraqitura në tabelën 4, vërehet kjo se ato ishin variabile në mes kultivarëve testues dhe atij standard apo krahasues (Grand), si dhe dallimet e tyre në mes lokaliteteve. Të gjitha rezultatet e tabelës së mësipërme do t'i paraqesim në grafikët nga 5 deri 10.



Fotografia 10. Fushat eksperimentale të kultivarëve elbit që janë testuar në lokalitetin e Pejës gjatë vegetacionit të vitit 2109 / 2020




Fotografia 11. Fushat eksperimentale të kultivarëve elbit që janë testuar në lokalitetin e Lipjanit gjatë vegetacionit të vitit 2019 / 2020



Grafiku 5. Rendimenti (t / ha) te elbi i testuar dhe krahasuar në mes dy lokaliteteve testuese (Pejë dhe Lipjan)

Në grafikun e mësipërm, janë paraqitur rezultatet mesatare të rendimentit të elbit (t / ha), për fushat eksperimentale që janë testuar në lokalitet Pejë dhe Lipjan. Matjet e parametrimit të rendimentit janë bërë për secilin kultivarë dhe secilën fushë testuese. Megjithatë, rezultatet e kultivarëve testues janë krahasuar me rezultatet e kultivarit standard apo krahasues (Grand). Në këtë rast, rendimenti më i lartë në lokalitetin e Pejës, është vërejtur tek kultivari E-1 (7.90 t / ha), ndërsa rendimentin më të ulët në këtë lokalitet është vërejtur tek kultivari E-2 (7.17 t / ha). Dallimi në mes rendimentit maksimal dhe atij minimal ishte 0.73 t/ha, apo 9.24 %, rendiment më të lartë kishte kultivari E-1, në raport me kultivarin E-2, që kishte rendiment minimal. Ndërsa, kultivari standard apo krahasues Grand rendimentin në lokalitetin e Pejës e kishte 7.38 t / ha. Rendimenti mesatarë i të gjithë kultivarëve testues, duke e përfshirë edhe kultivarin standard krahasues në lokalitetin e Pejës, ishte 7.48 t / ha. Sa i përket rendimentit në lokalitetin e Lipjanit, vlerat më të larta janë vërejtur te kultivarët E-1 dhe Grand me vlera të njëjta 7.20 t / ha, ndërsa rendimenti më të ulët në këtë lokalitet është vërejtur tek kultivari E-2 (5.97 t / ha). Dallimi në mes rendimentit maksimal dhe atij minimal, ishte 1.23 t / ha, ose 17.08 % rendiment më të lartë kishin kultivarët E-1 dhe Grand, në raport me kultivarin E-2, që në këtë rast kishte rendiment minimal. Rendimenti mesatarë i elbit në lokalitetin e Lipjanit, për të gjithë kultivarëve testues, përfshirë edhe kultivarin standard krahasues, ishte 6.79 t / ha.




Grafiku 6. Mesatarja e përgjithshme e rendimentit (t / ha) të elbi, përfshirë dy lokalitetet testuese (Pejë dhe Lipjan)

Në mënyrë grafike, janë paraqitur rezultatet mesatare të rendimentit (t / ha), për të gjithë kultivarët e elbit që janë testuar në dy regjionet agroklimatike të Republikës së Kosovës, në lokalitetet (Pejë dhe Lipjan). Në këtë rast, mesataren maksimale të rendimentit në dy lokalitetet kishte dhënë kultivari E-1 (7.55 t / ha), ndërsa rendimenti më i ulët mesatarë është vërejtur tek kultivari E-2 (6.57 t / ha). Dallimi në mes rendimentit mesatarë maksimal dhe atij minimal ishte 0.98 t / ha, apo 12.98 % rendimet më të lartë kishte kultivari E-1, në raport me kultivarin E-2, që në këtë rast rendimentin mesatar të dy lokaliteteve e kishte minimal. Kultivari standard apo krahasues Grand, rendimentin mesatarë të dy lokalitetet e kishte 7.29 t / ha. Mesatarja e përgjithshme e rendimentit për të gjithë kultivarët që ishin në hulumtim, përfshirë edhe kultivarin standard krahasues në dy lokalitetet, ishte 7.14 t / ha.

Analiza e variancës për parametrin e rendimentit ka gjetur se dallimet ishin signifkante për dy faktorët në nivelin e $p < 0.01$ siç shihet edhe nga tabela 5 në vijim.

Tabela 5. Analiza e variancës për rendiment t/ha


Burimi	ShL	Adj SS	Adj MS	F	P
Lokaliteti	1	8.2824	8.28245	62.69	0.000
Gjenotipi	2	5.2827	2.64136	19.99	0.000
Gabimi	14	1.8496	0.13211		
Lack-of-Fit	2	1.7004	0.85020	68.38	0.000
Gabimi i pastër	12	0.1492	0.01243		
Totali	17	15.4148			



Grafiku 7. Masa hektolitare (kg / hl) te elbi i testuar dhe krahasuar në mes dy lokaliteteve testuese (Pejë dhe Lipjan)

Në grafikun e 7, janë paraqitur rezultatet mesatare të fushave eksperimentale të elbit, ku është vlerësuar masa hektolitare (kg/hl), në lokalitetet Pejë dhe Lipjan. Peshë hektolitare është analizuar për secilin kultivarë testuese, ndërsa rezultatet e tyre janë krahasuar me rezultatet e kultivarit standard krahasues (Grand). Në këtë rast, peshë më e lartë hektolitare në lokalitetin e Pejës, është vërejtur tek kultivari standard Grand (71 kg / hl), ndërsa peshë hektolitare më e ulët në këtë lokalitet, është vërejtur tek kultivari E-1 (67.80 kg / hl). Dallimi në mes peshës hektolitare maksimale dhe

asajë minimale në lokalitetin e Pejës, ishte 3.20 kg / hl, ose 4.51 %, peshën më të lartë hektolitare e kishte kultivari standard Grand, në raport me kultivarin E-1 që e kishte peshën hektolitare minimale. Në këtë rast, peshën hektolitare kultivari tjetër testues E-2 e kishte 69 kg / hl. Pesha mesatare hektolitare e gjithë kultivarëve testues, duke e përfshirë edhe kultivarin standard apo krahasues, në lokalitetin e Pejës ishte 69.27 kg / hl. Ndërsa, pesha më e lartë hektolitare në lokalitetin e Lipjanit, është vërejtur tek kultivari E-2 (67.90 kg / hl), ndërsa pesha hektolitare më e ulët, në këtë lokalitet është vërejtur te kultivari standard Grand (65.90 kg / hl). Dallimi në mes peshës hektolitare maksimale dhe asajë minimale, ishte 2 kg / hl, ose 2.95 %, peshë më të lartë hektolitare kishte kultivari E-2, në raport me kultivarin standard Grand, që e kishin peshën hektolitare minimale në lokalitetin e Lipjanit. Në këtë rast, peshën hektolitare kultivari tjetër testues E-1, peshën hektolitare e kishte 67.70 kg / hl. Pesha mesatare hektolitare e të gjithë kultivarëve testues, duke e përfshirë edhe kultivarin standard apo krahasues, në lokalitetin e Lipjanit, ishte 67.17 kg / hl.



Grafiku 8. Mesatarja e përgjithshme e mases hektolitare (kg/ha) te elbi, përfshirë dy lokalitetet testuese (Pejë dhe Lipjan)

Tabela 6. Analiza e variancës për masë hektolitare kg/hl


Burimi	ShL	Adj SS	Adj MS	F	P
Lokaliteti	1	19.845	19.8450	10.83	0.005
Gjenotipi	2	1.960	0.9800	0.53	0.597
Gabimi	14	25.648	1.8320		
Lack-of-Fit	2	21.000	10.5000	27.11	0.000
Gabimi i pastër	12	4.648	0.3873		
Totali	17	47.453			

Sikur se shihet nga tabela 6, analiza e variancës ka gjetur se lokaliteti kishte sinfigancën e lartë të rëndësisë përkatësisht rëndësia e dallimit statistikor ishte e nivelit $p < 0.01$, por faktori gjenotip/kultivar nuk kishte dallime statistikore biometrike ne asnjërin nivel te rëndësisë për këtë parametër.

Në mënyrë grafike (graf. 8), janë paraqitur rezultatet mesatare të masës hektolitare (kg / hl), për të gjithë kultivarët e elbit që janë testuar në dy regjionet agroklmatike të Republikës së Kosovës, (në lokalitetet Pejë dhe Lipjan). Në këtë rast, mesataren maksimale të masës hektolitare në dy lokalitetet e kishin kultivarët E-2 dhe ai standard apo krahasues Grand, me vlerë të njëjtë mesatare 68.45 kg / hl, ndërsa mesatarja më e ulët e masës hektolitare, është vërejtur tek kultivari E-1 (67.75 kg / hl). Dallimi në mes masës hektolitare mesatare maksimale dhe asajë minimale, ishte 0.70 kg / hl, apo 1.02 % masës hektolitare mesatare më të lartë e kishin kultivarët E-2 dhe Grand, në raport me kultivarin E-1 që në këtë rast e kishte masës hektolitare minimale, në dy lokalitetet. Mesatarja e përgjithshme e masës hektolitare për të gjithë kultivarët e testuar, përfshirë edhe kultivarin standard krahasues në dy lokalitetet, ishte 67.75 kg / hl.

Në grafikun vijues, janë paraqitur rezultatet e masës absolute (*masës e 1000 farave*), të kultivarëve të elbit që ishin testuar në lokalitetet Pejë dhe Lipjan. Rezultatet e dy kultivarëve testues janë krahasuar me rezultatet e kultivarit standard krahasues (Grand). Në këtë rast, masa më e madhe e 1000 farave në lokalitetin e Pejës, është vërejtur tek kultivari E-2 (48.70 g), ndërsa masa më e ulët në këtë lokalitet, është vërejtur tek kultivari E-1 (42.42 g). Dallimi në mes peshës absolute maksimale dhe asajë minimale në lokalitetin e Pejës, ishte 6.28 g, ose 12.90 %, masë absolute më të madhe kishte kultivari E-2, në raport me kultivarin E-1 që e kishte peshën absolute minimale. Në


